



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA E PROKURIMIT PUBLIK
DREJTORIA JURIDIKE DHE E MONITORIMIT TË PROCEDURAVE

Nr. 3356/2 Prot.

Tiranë, më 15.04. 2026

REKOMANDIM
MBI
VERIFIKIMIN E STATUSIT TË OPERATORËVE EKONOMIKË PËRPARA
NËNSHKRIMIT TË KONTRATAVE/ MARRËVESHJES KUADËR APO
MINIKONTRATAVE

Drejtuar: Autoriteteve/Enteve Kontraktore dhe Operatorëve Ekonomikë

Mbështetur në nenin 23, gërma “b” dhe “ç”, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar (në vijim “LPP”), Agjencia e Prokurimit Publik (në vijim APP), me qëllim mirëzbatimin e kuadrit ligjor për prokurimin publik, rekomandon autoritetet/entet kontraktore të mbajnë në konsideratë si më poshtë:

Në nenin 78/1/a të LPP parashikohet se: *“Agjencia e Prokurimit Publik përjashton një operator ekonomik nga e drejta për të fituar kontrata publike për një periudhë nga 3 muaj deri në 3 vjet për keqinformim dhe dorëzim të dokumenteve, që përmbajnë të dhëna të rreme për qëllime kualifikimi”.*

Qëllimi i LPP, konkretisht i nenit 78/1 të tij, është të ndalojë fitimin e kontratave publike nga operatorët ekonomikë të përjashtuar.

Nëse një operator ekonomik përjashtohet me vendim të APP, nga e drejta për të fituar kontrata publike, pas datës së vendimit të përjashtimit, ai nuk mundet të nënshkruajë kontratë, apo minikontratë brenda një marrëveshje kuadër, përsa kohë që është në fuqi vendimi i APP për përjashtim.

Nëse, operatori ekonomik rezulton i përjashtuar para nënshkrimit të kontratës/minikontratës brenda marrëveshjes kuadër, autoriteti kontraktor nuk duhet të vijojë me nënshkrimin e kontratës/minikontratës me këtë operator ekonomik, pasi bie ndesh me parashikimet e nenit 78/1 të LPP.

Mosrespektimi i rregullave të prokurimit, në përputhje me dispozitat e këtij ligji, kur përbën kundërvajtje administrative, dënohet me gjobë në përputhje me parashikimet e nenit 132 të LPP.

Për këtë qëllim, APP rekomandon autoritetet/entet kontraktore që përpara nënshkrimit të çdo kontrate apo minikontrate brenda një marrëveshjeje kuadër të forcojnë mekanizmat e verifikimit dhe kontrollit paraprak. Konkretisht, ato duhet të sigurojnë një kontroll të përditësuar të listës së operatorëve ekonomikë të përjashtuar, që publikohet nga APP në faqen zyrtare të saj, si në Buletinin e Njoftimeve Publike, ashtu edhe tek seksioni “Të tjera”- “Operatorë ekonomikë të përjashtuar”.

Gjithashtu, që nga momenti i marrjes së vendimit për shpalljen fitues të një operatori ekonomik e deri tek nënshkrimi i kontratës, autoriteti/enti kontraktor duhet të kryejë verifikime tek seksioni “Transparenca”- “Të dhënat e vendimeve” në faqen zyrtare të APP, ku kjo e fundit publikon në mënyrë të përmbledhur vendimet e marra për përjashtimin e operatorëve ekonomikë.

Nëpërmjet verifikimit paraprak, autoritetet/entet kontraktore jo vetëm që zbatojnë në mënyrë rigorozë dispozitat e LPP, por edhe mbrojnë interesin publik, duke shmangur lidhjen e kontratave me subjekte, që kanë cënuar besueshmërinë, si dhe duke garantuar një proces prokurimi të drejtë, të barabartë dhe transparent.

Së fundmi, rekomandojmë që:

Autoriteti/enti kontraktor për të vijuar me nënshkrimin e kontratës apo të një minikontrate brenda një marrëveshjeje kuadër duhet të mbajë në konsideratë në çdo rast, statusin e operatorit ekonomik në momentin e nënshkrimit të këtyre akteve. Gjithashtu, operatorët ekonomikë në rast se ka një vendim në fuqi nga APP për përjashtimin e tyre, nuk duhet të vijojnë me nënshkrimin e kontratës apo të një minikontrate brenda një marrëveshjeje kuadër.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

Reida Kashta

